



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 19.05.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 18.05.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Besa Security" për aktivitetin: "Sigurimi fizik i objekteve të Komunes" dhe me numër të prokurimit: 616 -19-3238-211 nxjerr:

V E N D I M

REFUZOHET kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik "Besa Security" e datës 18.05.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Sigurimi fizik i objekteve të Komunes" dhe me numër të prokurimit: 616 -19-3238-211 kundër *Njoftimit për Vendimin e AK-se të datës 13.05.2020*, të publikuar në web-faqe të KRPP-së.

1. **Vertetohet Njoftimi për Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 13.05.2020** ;
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "Besa Security" me datë 18.05.2020 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Sigurimi fizik i objekteve të Komunes" dhe me numër të prokurimit: 616 -19-3238-211.

Autoriteti Kontraktues, me datë 19.05.2020 dhe ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

Pretendimet tuaja janë të pa bazuara për arsyt në vijim:

-Konstatimi juaj se nuk ka asnjë OE-ik të përgjegjshëm dhe se duhet anuluar aktivitetin është i pa bazuar për faktin që edhe ju vetë e keni çekur në kërkesën tuaj: "Procedura e prokurimit pas marrjes së ofertave mund të anulohet për arsyen e mëposhtme: (i) të gjithë tenderet e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e AK-se", pra është e çekur qartë se mund të anulohet e nuk shkruan askund që duhet të anulohet;

-Pretendimi juaj se sqarimet tona e kane kushtezuar çmimin e tenderit tuaj poashtu eshte i pa qendrueshem,pasiqe ju keni cekur vetem nje pjese te teksit:”Lidhur me pyetjen tuaj referojuni dosjes se tenderit,saktesisht Aneksit 1 tek specifikimet teknike qe do te thot se kontrata kornize mund te shtohet per 30%e qe arrin vleren prej 2.730,000.00 €”,ndersa nuk e keni perfshire pjesen tjeter te pergjigjes qe sqaron se kemi te bejme me kontrate kornize dhe e njejta mund te nderprehet ne momentin qe arrin vleren e parashikuar,e cila pjese tregon qarte se nuk ka pase asnje kufizimin per çmimin tuaj as te tenderueseve tjere.Poashtu ne sqarimet tona eshte cekur se tenderuesit duhet ti perfshijne ne çmimet e tyre te gjitha detyrimet ligjore dhe ata qe nuk i pershijne te njejtat do te trajtohen si te pa pergjegjshem.

-Poashtu ju sqaroj se lidhur me tenderuesin e propozuar ne asnje rast as Autoriteti Kontraktues e as OSHP-ja nuk e kane trajtuar tenderuesin :”Rojet e Nderit”si te pa pergjegjshem,por vetem eshte konstatuar se çmimi i tij eshte mbi vleren e parashikuar;

-
Bazuar ne konstatimet paraprake konstatoj se pretendimet tuaja jane te pa bazuara dhe kerkesa juaj refuzohet.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**


Zyrtari përgjegjës i Prokurimit